



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 248, datë 09.06.2021

PËR
DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR GJYQTARES {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenin 24, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesën e gjyqtares {...} me nr. 2162 prot., datë 14.05.2021,

VENDOSI :

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare dhe shëndetësore, për një periudhë 40 (dyzet) ditore, e cila fillon në datë 14.06.2021 dhe mbaron në datën 24.07.2021.
2. Rindarjen me short të të gjitha çështjeve për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor dhe që gjyqtarja {...} i ka në shqyrtim në momentin e fillimit të lejes së papaguar.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR